



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 14.12.2022

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA MALËSI E MADHE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.3, DATË
09.12.2017
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.3, datë 09.12.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Malësi e Madhe”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 48 datë 31.10.2022, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Malësi e Madhe, të miratuar me Vendimin Nr.3, datë 09.12.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit:*
 - Në nenin 15 “*Madhësia e parcelës*”, pas pikës 6, shtohen pika 7;
 - Në nenin 18 “*Intensiteti i ndërtimit (I)*”, pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7 dhe 8;
 - Në nenin 29 “*Rregulla kufizuese në zomat e reja për zhvillim*”, pas pikës 1 shtohen pikat 1.1 deri në 1.6;
 - Pas nenit 29 “*Rregulla kufizuese në zomat e reja për zhvillim*”, shtohet neni 29/1 “*Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C*”;
 - Pas nenit 33 “*Përcaktimi i njësive strukturore për të cilat hartohet PDV*”, shtohet neni 33/1 “*Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm*”;
 - Pas nenit 36 “*Instrumenta të tjera incentivuese dhe frenuese të zhvillimit*”, shtohet neni 36/1 “*Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror*” dhe neni 36/2 “*Kushte për objektet ekzistuese në sistemin Bujqësor dhe Natyror*”;
 - Neni 41 “*A13- Zona të reja dendësi e ulët*”, ndryshohet;



- Neni 42 "A14- Zona të reja dendësi e mesme", ndryshohet;
 - Neni 46 "A23- Qendra vendbanimi/ zona mikse", ndryshohet;
 - Neni 48 "A31- Zona të formuara", ndryshohet;
 - Neni 49 "A32- Zona densifikimi", ndryshohet;
 - Neni 50 "A33- Zona të reja", ndryshohet;
 - Neni 51 "A34- Qendra vendbanimi/ zona mikse", ndryshohet;
 - Neni 54 "IE2- Zona aktivitete ekonomike", ndryshohet;
 - Neni 55 "S- Zonat e shërbimeve", ndryshohet;
 - Në nenin 65 "AR3- Zona sportive", pika 3 ndryshohet;
 - Në nenin 68 "V- Varreza", pika 3 riformulohet;
 - Në nenin 77 "IN2- Infrastrukturë Hekurudhore", pas pikës 3 shtohen pikat 4 deri në 7;
 - Pas nenit 80 "IN5- Infrastrukturë ankorimi", shtohet neni 80/1 "Kanalet vaditëse/ Emisaret";
 - Neni 88 "N1- Pyjet", ndryshohet;
 - Neni 89 "Monumente të natyrës", ndryshohet;
 - Në nenin 100 "Zgjidhja e konflikteve dhe mospërputhjeve", pas pikës 6 shtohen pikat 7 deri në 9;
- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Malësi e Madhe, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Malësi e Madhe dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Malësi e Madhe, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLEUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

